



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No: 05-8390
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: Date: 11/12/2020
Pristinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

Nr.888/XII/2020

Datë:11/12/2020

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të Nenit 145 (pika 2) e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7, 01 Mars 2019), në zbatim të nenit 89 të Ligjit nr. 04/1-125 për shëndetësi, në zbatim të Nenit 4, nenit 5 paragrafi 2.5, Nenit 12 paragrafi 4, Nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë covid-19 në territorin e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 7 të Rregullores Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr.01/42, datë 11/11/2020, në zbatim të rekomandimeve të IKSHPK-së me qëllim të kontrollit dhe parandalimit të përhapjes së virusit COVID-19, nxjerrë:

V E N D I M

1. Miratohen masat e veçanta për mbrojtjen nga pandemia COVID-19, në **Komunën e Shtimës**.
2. Masat e miratuara në Komunën e **Shtimës**, janë si më poshtë:
 - 2.1. Operatoret ekonomik lejohen të punojnë nga ora 05:00 deri në orën 18:00, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
 - 2.2. Shërbimet e hotelërisë dhe gastronomisë lejohen të punojnë nga ora 05:00 deri në ora 18:00, ndërkaq pas orës 18:00 punojnë me shërbim "merr me vete" dhe "porosi me dërgesë", në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
 - 2.3. Të gjitha institucionet publike dhe private reduktojnë stafin e tyre bazuar në specifikat që kanë në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
 - 2.4. Transporti publik lejohet të punojë me 50% të kapaciteteve, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
 - 2.5. Taksitë lejohen të punojnë me një (1) pasagjer prapa ose tre (3) nëse janë anëtarë të së njejtës familje, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19";
 - 2.6. Qendrat tregtare lejohen të punojnë nga ora 05:00 deri në orën 18:00, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19";

- 2.7. Lejohen pjesërisht aktivitetet kulturore të institucioneve vartëse të MKRS dhe komunave (teatrot, bibliotekat, filarmonia, galeritë, ansamblet, baleti, kinematë, qendrat rinore, muzetë, qendrat e kulturës me grupe dhe të ngjashme), duke shfrytëzuar vetëm 30% të hapësirës/sipërfaqeve të objekteve përkatëse për të gjitha aktivitetet (si në shfaqje ashtu edhe në ushtrime), në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19";
- 2.8. Lejohen aktivitetet sportive në hapësira të mbyllura dhe të hapura; stërvitjet dhe garat mund të organizohen në sportet individuale; gjatë stërvitjeve në hapësirat e mbyllura mund të marrin pjesë deri në 20 persona, ndërsa gjatë garave mund të marrin pjesë deri në 50 persona bazuar në protokolle dhe udhëzime vendore dhe ndërkombëtare sportive, në përputhje me "Manualin për mbrojtjen nga përhapja e COVID-19";
3. Dështimi në respektimin e këtyre masave në çdo rast, i nënshtrohet masave ndëshkimore në përputhje me Ligjin nr.07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës nga ana e Institucioneve përgjegjëse të cilat janë të **obliguara** të mbikqyrin dhe të sigurojnë zbatimin e këtyre masave.
4. Ky vendim vlenë deri në një vendim tjetër, bazuar në situatën epidemiologjike në vend;
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë në orën 18:00.

A r s y e t i m

Në bazë të vlerësimeve dhe rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, meqenëse Komuna e **Shtimës** kategorizohet me rrezik të mesëm të infeksionit, me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga COVID-19, për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes së menaxhimit të mjekimit nga institucionet shëndetësore lidhur me kapacitetet spitalore për trajtim, Ministri i Shëndetësisë në zbatim të Ligjit nr. 07/1-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Armend Zemaj**
Ministër i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;
- Komunës së Shtimës;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zëvendësministrave të Msh;
- IKSHPK-së;
- Policisë së Kosovës;
- Inspektoratit sanitar;
- Inspektoratit shëndetësor dhe Inspektoratit farmaceutik;
- Inspektorateve komunale;
- Departamenti ligjor;
- Divizionit për komunikim me publikun;
- QOE-Msh;
- Sekretarisë së Komitetit për Covid-19;
- Arkivit të MSh.